

Të Heshtësh e Të Durosh

Ose Të Largohesth Nga Puna



Embassy of Sweden
Pristina



Në vendin në të cilin është e pranueshme humbja në vendin e punës, mbetet ende shumë e vështirë gjetja e punëtorëve që rrëfejnë peripetitë e tyre, apo edhe të familjarëve e kolegëve. Ndër arsyet e shumta, rreziku i mundshëm që vjen nga identifikimi bën që shkeljet apo edhe tragjeditë në vendin e punës, të jenë ende sekret publik.

Në të shumtën e rasteve, shkaktar është edhe frika që nuk mund të gjejnë vend të ri të punës për arsye të influencës së punëdhënësit të mëparshëm. Po ashtu, shpesh nuk dëshmojnë edhe nga frika se me dëshminë e tyre, mund të rrezikohet dikush nga familjarët dhe miqtë e tyre që punojnë në të njëjtat biznese apo në biznese të tjera të lidhura me pronarët e biznesit në fjalë.

Barrë kryesore në këtë pikë i bie kapaciteteteve monitoruese, që në realitet janë shumë të mangëta, ndikuar nga shumë faktorë e veçmas numrit të vogël të inspektorëve.

Punëtorët shpesh nuk besojnë se përmes ankesës mund të zgjidhet problemi, sidomos në sektorin privat.

Nuk janë të rralla rastet kur punëtori detyrohet të largohet nga puna për arsye të presionit nga punëdhënësi, që në fakt është largim nga puna.

I tillë është dhe rasti i punëtores T, e cila për më shumë se dy vite duroi kushte mjaft të vështira të punës, duke ditur që papunësia është shumë e madhe dhe do të ishte lehtë e zëvendësueshme në pozitën e punës që mbante.

Në supermarketin ku ajo punonte, nuk kishte fare ngrohje në muajt e ftohtë të dimrit. Edhe pse ngrohja ishte një nga parakushtet për mbarëvajtjen e punës, ajo për dy vite jo vetëm që duroi qëndrimin gjatë gjithë kohës në këmbë në arkë por ishte e detyruar që të punonte dhe në të ftohtë.

Ajo nuk kishte guxim që nga punëdhënësi të kërkonte përmirësimin e kushteve të punës, gjithnjë nga frika për humbjen e punës.

Menaxherja përgjegjëse u doli në ndihmë punëtorëve sepse e kishte të qartë që ishte shumë e vështirë të punohej në këto kushte dhe provoi t'u bënte një zgjidhje të pjesshme, duke sjellë një ngrohëse të vogël për punëtorët e saja që punonin tek arka.

Shumë shpejt, drejtori vërejti se ç'kishte ndodhur dhe kërkoj shpjegim.

Nga drejtori i kompanisë, kjo u konsiderua si shkelje e rëndë e punës. Për këtë arsye, ai e largoi nga puna menaxheren.

Në akuzën e tij për menaxheren dhe tri punëtorët, ai iu drejtua atyre se "keni vjedhur rrymë" dhe keni keqpërdorur kompaninë.

Pas pushimit nga puna të menaxheres nga drejtori, pasi u konsiderua si fajtorja kryesore, nga ajo çfarë dëgjuan nga drejtori, punëtorët e kuptuan që njëkohësisht edhe vendi i punës së tyre është shuar dhe u larguan vetë.

T ka pasur kontratë të punës e po ashtu dhe menaxherja, por që në këto rrethana, kuptohet që nuk janë respektuar as procedurat themelore të largimit nga puna, bazuar në kontratë dhe Ligj të Punës. Në një treg të mirëfilltë pune, pronarët e bizneseve apo drejtorët e institucioneve do të duhej ta kishin të qartë se mbarëvajtja e punës dhe maksimizimi i profitit për një biznes apo institucion, mund të vijë vetëm nga punëtorët që punojnë në kushte, që fillimisht, sigurojnë mirëqenien e tyre.

Në anën tjetër, edhe vetë punëtorët duhet të respektojnë kriteret dhe rregullat e shkruara të punës në Ligj dhe në kontratën e nënshkruar me rastin e punës.

Në rastin që është trajtuar nga një intervistimi i një punëtoresje që humbi punën për shkak të mungesës së kushteve elementare të punës, siç është ngrohja në vendin e punës, është e qartë se në rend të parë është cenuar shëndeti i punëtorëve. Kur cenohet shëndeti, kemi një zinxhir të problemeve që dalin si efekt, siç është mungesa nga puna për shkaqe shëndetësore, koha e gjatë e rehabilitimit në shumë raste, që ndikon direkt në produktivitetin në punë.

Në rastin në fjalë dhe në shumë raste të tjera, nuk janë këto brenga të punëdhënësve, sepse ata nuk merren me shëndetin e punëtorëve e as me pushimet mjekësore, por me lehtësi e zëvendësojnë me një punëtor tjetër që pret në radhët e gjata për shkak të papunësisë së madhe.

Vetëm me përforsimin e kapaciteteve monitoruese, rritje të inspektorëve dhe respektim të ligjit, mund të eliminohen këto defekte.